REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 05/17
Datë/Datum. 03.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 05/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Security Code Sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, me titull: "Sigurimi fizik i MSH-së dhe Depos së barnave" Lot 1 dhe 2, me nr prok: "206/16/062/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Shëndetësisë/, më datën 13.02.2017 mori këtë:

VENDIM

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Security Code Sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i MSH-së dhe Depos së barnave" Lot 1 dhe 2, me nr prok: "206/16/062/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Shëndetësisë/.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Ministria e Shëndetësisë/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i MSH-së dhe Depos së barnave" Lot 1 dhe 2, me nr prok: "206/16/062/221", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "Security Code Sh.p.k" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa i është aprovuar si e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:21.10.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 22. 11. 2016, ku kanë marr pjesë dhjetë (10) operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 21.12.2016, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Alpha Private Security"- Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Security Code Sh.p.k" – Prishtinë, me dt:27.12.2016, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 29.12.2016, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Security Code Sh.p.k" - Prishtinë.

Operatori ekonomik "Security Code Sh.p.k" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 06 janar 2017 me nr. 05/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Sigurimi fizik i MSH-së dhe Depos së barnave" Lot 1 dhe 2, me nr prok: "206/16/062/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 par. 1
- Neni 17 par.1 i Rregullores për Prokurim Publik
- Neni 35.3 pika 1,2,3,4,5,6 dhe 7 të UOPP-së
- Neni 52 par.3 i LPP-së
- Neni 59 par.4 i LPP-së
- Neni 60 par1 i LPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 24 janar 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të refuzoj si të pabazuar, ankesën e OE ankues "Security Code Shpk" me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe të aprovoj vendimin e Autoritetit Kontraktues njoftimin për dhënien e kontratës i datës 21.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit "Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos se barnave" për Lot 1 dhe 2, me nr.prokurimi "616/16/107/221" të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Autoriteti Kontraktues me datë: 25 janar 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Security Code Shpk– Prishtinë, me datë: 25 janar 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.02.2017, ku kanë qenë prezent palët e përfshira në procedurë, anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Security Code" ka deklaruar: eksperti shqyrtues pretendimeve tona ankimore i është shmangur, ku thuhet tenderi i zgjedhur të përputhet me gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve përkatëse. AK – MSH e ka vënë si kusht pagën 250 € neto për një punëtor. Total në dosje të tenderit ka specifikuara se janë 9 punëtor që duhet të kenë pagën 250 €, dhe kjo është shumë kërkesë e qartë dhe e matshme. Si provë kemi kalkuluar pagën dhe ju ofroj një kopje të analizës financiare. OE i rekomanduar për kontratë pas llogaritjeve obligative për pagë 250 € neto, duke i shtuar trustet pensionale, tatimin në burim në pagë dhe pushimin vjetor, del se ky OE është nën pagë për një punëtor afërsisht 24 €. Gjatë pyetjes AK-MSH kur kemi kërkuar sqarim për pagën, na ka dhënë përgjigje se "pagës neto 250€ është kërkesë mjaft e qartë dhe duhet ta keni parasysh në ofertën tuaj". Ne e kemi përfillë këtë kërkesë të AK dhe kemi llogaritur pagën 250€ neto në ofertën tonë, gjatë dhënies së çmimit. Ju ofroj edhe analizën që e kemi bërë për ofertën tonë se si e kemi llogaritur çmimin për pagë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MSH ka deklaruar: "Ne mbështesim raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE i rekomanduar për kontrata ka deklaruar: "Ne mund të ju dëshmojmë me dëshmi me analizë financiare , dhe në faqe të ATK-së, ku është formula si kalkulohet paga 250€, dhe ajo bruto. Është formë e dëshmuar me gjitha çmimet që kemi dhënë

dhe qëndrojmë pas deklaratës qe kemi dhënë ne si OE. Pos kësaj kemi shtuar edhe TVSH-në që mbulon komplet çmimin e ofruar.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: "I sqaroj panelit shqyrtues se kemi të bëjmë me një pretendim ankimorë i cili lidhet me kriterin e përcaktuar në dosje dhe njoftim për kontratë për pagën neto 250€ për një të punësuar. Për këtë kriter kam sqaruar pretendimin ankimorë dhe sipas çmimit të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë duke e llogaritur numrin e punëtorëve dhe sipas kalkulimit që gjendet në faqe të ATK për pagë neto, del se OE i rekomanduar për kontratë mbulon pagën 250 € sipas çmimit që ka dhënë në ofertën e tij origjinale. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore sipas OE ankues për drejtat e punëtorëve këto çështje janë kompetencë e AK-së gjatë implementimit të kontratës dhe inspektoratit të punës. Po ashtu e njëjta sa i përket kriterit të pagës AK është i obliguar gjatë implementimit të përcjell në përpikëri këtë kriter. Po ashtu OE ankues i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe deklaratën sipas dosjes që paga të jetë 250€ neto për çdo të punësuar. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës së datës 24.01.2016.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Security Code shpk" ka deklaruar: "Ne si do donim të dimë se me cilat vlera është kalkuluar paga prej 250€ ?. Dosja tenderit ka potencuar se ofertat duhet të jenë në pajtim me ligj të punës, mirëpo me ligj të punës parashihet edhe pushimi vjetor e i cili nuk është llogaritur në çmimin e OE fitues. I propozojmë panelit të aprovohet ankesa jonë e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Në përgjigje eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Në faqe të ATK, kalkulimi është shumë i thjesht pasi vetëm shënohet paga neto, dhe kalkulimet tjera bëhen nga sistemi i ATK-së".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE të rekomanduar për kontratë ka deklaruar: "270.94€ paga bruto për pagë neto 250 €. I ofroj panelit si provë kalkulimin detal se si kemi arritur deri te çmimi ynë dhe se i njëjti plotëson kërkesën e AK-së".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK-MSH ka deklaruar: "I propozojmë panelit shqyrtues që të refuzoj ankesën e OE ankues dhe të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar".

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe të gjitha argumenteve dhe fakteve relevante konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ju ka përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit në lidhje me përllogaritjen e pagës neto prej 250 € për të gjithë ofertuesit. Paneli shqyrtues konstaton se nuk është dëshmuar nga ana e autoritetit kontraktues se janë marr parasysh të gjitha elementet për përllogaritjen e pagës neto për OE të rekomanduar për kontratë sipas dispozitave të Ligjit të Punës në fuqi, pasi që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përfshirë në përllogaritjen e pagës pushimet vjetore të punëtorëve.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave dhe gjatë analizës financiare duhet ti përmbahet Ligjit të punës gjatë përllogaritjes së pagës për punëtorë duke i përfshirë të gjitha pushimet, kontributet etj, për të ardhur deri te vlerësimi real dhe analiza reale financiare sipas kërkesës së dosjes së tenderit me qëllim të trajtimit në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit.

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh dëshmitë dhe faktet e lartpërmendura konstaton se nuk është respektuar neni 52, 56, 59 dhe 60 i LPP-së

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Shëndetësisë"

1x1 OE – "Security Code Shpk" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.